

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fituesit e Medaljes Fields ngrenë shqetësime për ndikimin e IA-së në matematikë
ADRESA	https://albeu.com/teknologji/fituesit-e-medaljes-fields-ngrene-shqetesime-per-ndikimin-e-ia-se-ne-matematike/1010876/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 12:48:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 12:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1e44150e09251bf79d85cb035f5f26abdc239e9bfa1f0c5cf358e5398889e76
TEKSTI	d39e9ca3239d314e6d636756ccdac97186cd38904113b61b43e4b9f97792708c
PAMJA	c38a514f228197be771179d7efe55070c7c378ff4f2af59c46ba63be8ffe2726

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	61c97d94bce8002c65a64a7df62ce32a595340a03d68200655ae1250f935765d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/61c97d94bce8002c65a64a7df62ce32a595340a03d68200655ae1250f935765d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fituesit e Medaljes Fields ngrenë shqetësime për ndikimin e IA-së në matematikë



Ndërsa po diskutohet nëse zhvillimi i inteligjencës artificiale po përballlet me një ngadalësim të përgjithshëm, zhvillimet e fundit në matematikë mund të duken fillimisht si një çështje e veçuar.

Por një vështrim më i kujdesshëm tregon se të dyja temat kanë pika të rëndësishme takimi. Pas njoftimit të OpenAI-së, javën e kaluar, se kishte zgjidhur një Problem të Mijëvjeçarit në matematikë, komuniteti matematikor u përfshi në debate të forta. Diskutimet u përqendruan te përdorimi i mundshëm i punës së mëparshme njerëzore nga kompania, te ligjshmëria e këtij përdorimi dhe te standardet e publikimit që mund të ishin shkelur.

Në përfundim të javës, reagimi mori një drejtim edhe më themelor. Njëzet e pesë fitues të Medaljes Fields, vlerësimi më i lartë në matematikë, firmosën një letër të hapur të pazakontë. Ata kundërshtojnë një skenar që deri pak vite më parë do të dukej si pjesë e fantashkencës: mundësinë që sistemet e inteligjencës artificiale të zgjidhin probleme matematikore pa e kuptuar njeriu konceptin që qëndron pas tyre.

Rezultati nuk është i njëjtë me kuptimin

Letra u nxit nga përparimet e fundit, të cilat janë cilësuar spektakolare në matematikën e mbështetur nga inteligenca artificiale. Nënshkruesit nuk e kanë në qendër të kritikës vlefshmërinë e rezultateve, por dallimin mes një përgjigjeje të saktë dhe dijes së mirëfilltë. Sipas tyre, "zgjidhja e problemeve është thjesht një mjet", ndërsa synimi kryesor i matematikës është kuptimi i strukturave dhe ideve themelore, jo vetëm prodhimi i pohimeve të sakta ose të gabuara.

Probleme të njohura si ekuacionet Navier-Stokes, të cilat u zgjidhën, kanë pasur gjithmonë një rëndësi që shkon përtej vështirësisë teknike. Për matematikanët, ato kanë qenë pika nisjeje drejt ideve të reja. Procesi i kërkimit dhe sidomos zgjidhja e problemit merrnin vlerë sepse sillnin metoda të panjohura, lidhje befasuese dhe mënyra të reja arsytimi. Nëse sistemet e IA-së fillojnë të japin përgjigje të gatshme në një numër gjithnjë e më të madh,

të fundit /



Fituesit e Medaljes Fields ngrenë shqetësime për...



Marshim në Shkup për ish-krerët e UÇK-së, Forumi Rinor Shqipta...



Shtyhet seanca ndaj 13 policëve të akuzuar për tragjedinë në "Pulse",...



Prishtina miraton lokacionet për "Prishtina 2030", 71 p...



Loredana përplas Real Madridin me Barcelonën, koment...



Klevis Balliu: Arben Ahmetaj është në rrezik, po kërkojnë ta...



Vushtrria në krizë pas gjashtë humbesh, Ditmar Bicaj kandidat...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

ky proces krijues mund të vinent në trezik.

Mes firmëtarëve janë Terence Tao nga UCLA dhe Peter Scholze nga Instituti Max Planck për Matematikë, dy prej emrave më të rëndësishëm të kësaj fushe. Ata dhe kolegët e tyre paralajmërojnë se prodhimi i pritshëm në masë i rezultateve matematikore nga makinat mund të shtojë numrin e zgjidhjeve, por njëkohësisht të ngadalësojë lindjen e ideve të reja. Një zhvillim që në pamje të parë mund të interpretohet si sukses shkencor, në perspektivë afatgjatë mund të dobësojë mjedisin intelektual të matematikës.

Pasojat mund të shtrihen edhe në mësimdhënie

Shqetësimet nuk lidhen vetëm me kërkimin shkencor, por edhe me mënyrën se si mësohet matematika. Kjo fushë është një përpjekje ndërbreznore, ku njohuritë përcillen përmes seminareve, leksioneve dhe bisedave të drejtpërdrejta. Studiuesit e rinj nuk marrin vetëm rezultatet, por edhe mënyrën e të menduarit. Në letërën e tyre, matematikanët thonë se brezat e rinj marrin "pishtarin e dijes" nga paraardhësit. Pikërisht ky transmetim njerëzor, bashkë me procesin e verifikimit, konsiderohet i kërcënuar.

Edhe në rast se IA-ja do të prodhonte ide matematikore, njerëzit do të duhej t'i kuptonin, t'i provonin, t'i sistemonin dhe t'i lidhnin me njohuritë ekzistuese. Pa këto hapa, rezultatet do të ishin vetëm vargje fjalësh. Përparimi i matematikës nuk mbështetet vetëm te përgjigjet, por edhe te ndërtimi dhe shqyrtimi i tyre në mënyrë bashkëpunuese. Një rol të rëndësishëm luan gjithashtu mënyra se si përparimet e IA-së po komunikohen aktualisht me publikun.

Gara mes kompanive të teknologjisë

Nënshkruesit shprehin kritika edhe ndaj konkurrencës së fortë mes kompanive teknologjike. Në përpjekje për të qenë të parat, kompanitë i nxjerrin rezultatet me shpejtësi, shpesh edhe pa i paraqitur si para-printime të rregullta. Kjo lë pak hapësirë për analizë shkencore, dokumentim dhe vendosje në kontekst. Zgjidhja e problemit të ekuacioneve Navier-Stokes përmendet si një shembull veçanërisht i dobët i këtij fenomeni.

Pyetja që shtrohet është nëse mund të flitet ende për përparim intelektual, nëse një makinë zgjidh problemet më të vështira të botës, ndërsa njerëzit nuk arrijnë të kuptojnë arsyetimin e saj. Për momentin, firmëtarët përgjigjen me skepticizëm. Frika e tyre nuk lidhet me mundësinë që makinat të jenë më të afta se njerëzit, por me krijimin e një bote ku përgjigjet shtohen, ndërsa kuptimi i tyre pakësohet. Humbja nuk do të ishte vetëm matematikore, por do të prekte një përvojë thelbësore njerëzore: rrugëtimin e gjatë dhe të vështirë drejt dijes.

Një listë tjetër dhe largimi nga universiteti

Përveç kësaj liste, në komunitetin matematikor po qarkullon edhe një dokument i dytë. Ai përfshin tashmë gati 400 matematikanë, të cilët kundërshtojnë çdo përdorim të IA-së në kërkim dhe çdo bashkëpunim me kompanitë e inteligjencës artificiale. Vetëm një person figuron në të dyja listat. Bëhet fjalë për matematikani gjerman Peter Scholze, një emër veçanërisht i njohur në këtë fushë.

Jacob Tsimerman është fituesi i fundit i Medaljes Fields që nuk shfaqet në asnjërën prej listave. Matematikani 38-vjeçar i Universitetit të Torontos e mori çmimin në fund të korrikut të këtij viti dhe tërhoqi vëmendjen me një njoftim të rëndësishëm. Ai bëri të ditur se, duke nisur nga shtatori, do të merrte pushim nga universiteti për të punuar në sigurinë e IA-së në OpenAI. Ky vendim rikthen lidhjen mes debatit në matematikë dhe diskutimit më të gjerë për inteligjencën artificiale.

Javën e kaluar, në New York Times, Tsimerman njoftoi gjithashtu krijimin e Institutit të Sigurisë së IA-së Matematikore (MAISI), një qendër e pavarur kërkimore në Silicon Valley të Kalifornisë. Duke filluar nga janari i vitit 2027, një grup fillestar prej dhjetë deri në tridhjetë matematikanë do të merret atje me çështje themelore të sigurisë së IA-së./ Der Standard.

Shtuar më 14.09.2026 14:44



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.